



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 570, datë 20.11.2020

### PËR

### VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TIRANË PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIM NR. 396, DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, të kandidates znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendim nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

### VËREN

#### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”*

2. Në këtë vendim afati i kandidimit është përcaktuar “*deri më datë 23.10.2020*”.

3. Ky vendim i Këshillit është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 07.10.2020, duke filluar të ecë afati i kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 08.10.2020.

4. Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Më herët, me Vendimin nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 Këshilli ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës penale. Për këto tre pozicione të lira ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}.

6. Me Vendim nr. 238, datë 07.07.2020 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët që kanë kandiduar, ndër të tjerë, edhe për tre pozicionet e lira sipas pikës 5 të këtij vendimi, përfshirë edhe për kandidaten znj. {...}. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidatës në fjalë, me short, si relator, është caktuar anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me tre kriteret formale<sup>1</sup> të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë , për tre pozicionet e lira të shpallura me këto vendimi, që të trija në fushën e të drejtës penale. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 284, datë 08.09.2020, Këshilli vendosi:

1. *Verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

2. *Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për*

---

<sup>1</sup> *Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.*

7. Aktualisht kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kësaj kandidate në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit.

8. Ndërkohë, Këshilli, në Mbledhjen Plenare të datës 07.10.2020 në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë kushtetuese për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor si dhe të zhvillimit të karrierës gjyqësore, vendosi që të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht, Këshilli vendosi hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për nëntë pozicioneve të lira, në fushën e të drejtës civile dhe penale, (Vendimet nr. 389-397)<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> *Vendimi nr. 389, datë 07.10.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

*Vendimi nr. 390, datë 07.10.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.*

*Vendimi nr. 391, datë 07.10.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

*Vendimi nr. 392, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

*Vendimi nr. 393, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.*

*Vendimi nr. 394, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

*Vendimi nr. 395, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

*Vendimi nr. 396, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.*

*Vendimi nr. 397, datë 07.10.2020, Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.*

9. Brenda afatit të kandidimit për këto pozicione të lira, ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}, duke përcaktuar pozicionet për të cilat do të vijojë konkurrimin, konkretisht, dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 184 nr. 185 datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 396 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njëkohësisht znj. {...} në kërkesën e saj ka hequr dorë/është tërhequr nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes, me Vendimin nr. 539 datë 05.11.2020 vendosi :

- 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.*

11. Ndërkohë, mbas përfundimit të afatit të kandidimit për pozicionet e lira sipas pikës 1 të këtij vendimi, Këshilli, me Vendimin nr.541, datë 05.11.2020, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura, ndër të tjerë, edhe me vendimin në fjalë<sup>3</sup>. Në këtë rast, sipas këtij vendimi<sup>4</sup>, procedurat e verifikimit për kandidatët të cilët kishin kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, do të vijonin të kryheshin nga të njëjtët relatorë, bazuar kjo në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit 75/2019, ku përcaktohet se: “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Referuar këtij përcaktimi, në pikën 3 të vendimit,

---

<sup>3</sup> Vendimin nr.396, datë 07.10.2020.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 541, datë 05.11.2020.

Këshilli vendosi që për kandidaten znj, {...} e cila ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime (*nënkupto këtu Vendimet nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020*), është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020.

12. Më datë 05.11.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020.

13. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

14. Sa i përket verifikimit të plotësimin nga kandidatja znj {...} të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, pra të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidatja është verifikuar për plotësimin e këtyre kriterëve në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicionet e tjera të lira në të njëjtën fushë të së drejtës, pra atë penale<sup>5</sup>, u çmua se nuk kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi dokumentacioni i administruar më parë. Gjithsesi, për kriteret e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” u kryen disa veprime verifikuese, sikurse do të përshkruhen më poshtë, në funksion të verifikimit të ekzistencës së ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë,

---

<sup>5</sup> Për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

kjo për shkak se këto rrethana janë potencialisht të ndryshueshme qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT**

### **15. Për kriterin e “përvojës profesionale minimale”.**

16. Plotësimi nga kandidatja i kriterit të “përvojës profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, është verifikuar me parë nga Këshilli në kuadër të kandidimeve të mëparshme të saj për tre pozicione të lira në këtë fushë të së drejtës, referuar për këtë Vendimit të tij nr. 284, datë 08.09.2020, në të cilin është arritur në përfundimet se:

*“20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.”*

*24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.*

17. Kandidatja znj. {...} sikurse më herët, edhe në rastin e kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, ka kandiduar për të njëjtën fushë të së drejtës, atë penale dhe për rrjedhojë, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, ajo rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, nga të cilat mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale dhe “përvojës specifike profesionale minimale”.

### **18. Për kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

19. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 23.10.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

20. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 174 nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ka rezultuar se kandidatja znj. {...} nuk kishte masa disiplinore në fuqi, ndërsa në pikën 29, të Vendimit nr. 284, datë 08.09.2020, Këshilli ka arritur në përfundimin se: *“Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi”*

21. Ndërkohë, pra mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 284, datë 08.09.2020, nuk rezulton që ndaj kandidates të jetë marrë ndonjë masë disiplinore<sup>6</sup>. Për rrjedhojë, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*.

## **22. Për kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.**

23. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 23.10.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

24. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 174 nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, në pikën 34, të Vendimit nr. 284, datë 08.09.2020 Këshilli ka arritur në përfundimin se: *“Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten Këshilli vlerëson se znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë”*

25. Ndërkohë, mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 284, datë 08.09.2020, nuk rezulton ekzistenca e ndonjë rrethanë të ndryshme nga sa është konstatuar më parë në lidhje me qenien e

---

<sup>6</sup> Referuar nenit 105 të Ligjit për Statusin vendosja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

kandidates znj. {...} në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “*papajtueshmërisë ambientale*”.

### **III. KONKLUSIONE**

26. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit nr. 396 datë 07.10.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

27. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale me Vendim nr. 396, datë 07.10.2020.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**



1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**